



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

01 Nr. UA-152-126/09
06/02/2009

Në Bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, neni 1, pika 1.3 (d), siç është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. 2005/53 – Shtojca XV pika (V) dhe të nenit 20 të Ligjit për provimin e jurisprudencës nr. 02/L-40, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/30, Ministri i Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV
PËR PROGRAMIN DHE MËNYRËN E DHËNIES
SË PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS

Fushëveprimi
Neni 1

Me këtë udhëzim përcaktohet programi i provimit të jurisprudencës, puna e Komisionit për dhënie e provimit të jurisprudencës, përmbajtja e procesverbalit dhe e certifikatës për dhënie e provimit të jurisprudencës dhe mënyra e mbajtjes së evidencës për personat të cilët e kanë paraqitur dhe e kanë dhënë provimin e jurisprudencës si dhe të drejtat e kandidatit për ankim përkitazi me punën e Komisionit.

Përkufizimet
Neni 2

Për qëllim të këtij Udhëzimi administrativ, termet e mëposhtme kanë këto domethënie :

- 1) “Komision” nënkupton Komisionin për dhënie e provimit të jurisprudencës,
- 2) “Program” nënkupton programin për dhënie e provimit të jurisprudencës,
- 3) “Ministri” nënkupton Ministrin e Drejtësisë,
- 4) “Ministër” nënkupton Ministrin e Ministrisë së Drejtësisë,
- 5) “Provim “ nënkupton Provimin e jurisprudencës.

Lëndët e provimit Neni 3

Programi i provimit të jurisprudencës përmban lëndët e parapara në neni 4 dhe 5 i Ligjit për provimin e jurisprudencës, materien, burimet juridike dhe literaturën për secilën lëndë.

Kërkesa për dhënien e provimit Neni 4

1. Kandidati i cili i nënshtrohet dhënies së provimit ia parashtron kërkesën Ministrisë në përputhje me nenin 8 të Ligjit për provimin e jurisprudencës.
2. Në kërkesë kandidati duhet të theksojë kohën se kur dëshiron t'i nënshtrohet dhënies së provimit të jurisprudencës.
3. Kandidati ia bashkëngjit kërkesës dokumentet e vërtetuara me të cilat dëshmon se i plotëson kushtet ligjore që t'i nënshtrohet dhënies së provimit.
4. Ministria mund të kërkojë nga kandidati që t'i sjellë në shikim dokumentet origjinale dhe dëshmitë tjera të cilat janë të domosdoshme për lejimin e dhënies së provimit.

Vendosja lidhur me kërkesën Neni 5

1. Pas marrjes së kërkesës dhe dokumenteve tjera të nevojshme për lejimin e dhënies së provimit, konstatohet se kandidati a i plotëson apo jo kushtet e parashikuara për dhënien e provimit të parapara me nenin 8 paragrafi 8.3 të Ligjit për provimin e jurisprudencës, kurse Ministria miraton vendimin me të cilin kandidati i lejohet ose nuk i lejohet dhënia e provimit të jurisprudencës.
2. Ministria vendos lidhur me kërkesën e kandidatit në pajtim me nenin 4 të këtij Udhëzimi administrativ.
3. Vendimin e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni e nënshkruan Ministri apo personi të cilin e autorizon Ministri.

Afati për nënshtrimin e dhënies së provimit dhe shpenzimet Neni 6

1. Së bashku me vendimin me të cilin lejohet dhënia e provimit, kandidati njoftohet për kohën, vendin e dhënies së provimit, por jo me vonë se 30 ditë para ditës së caktuar për dhënien e provimit. Me kërkesën e kandidatit ky afat mund të jetë edhe më i shkurtër.
2. Kandidati njoftohet dhe për shumën e të hollave që duhet të paguaj për punën e Komisionit, lartësinë e të cilës me vendim e cakton Ministri.
3. Me vendim të Ministrit, caktohet shuma e të hollave që duhet të paguaj kandidati si kompensim për punën e Komisionit.
4. Kandidatët me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale të cilët janë shfrytëzues të ndihmës sociale dhe invalidët e luftës me mbi 50 % të shkallës së invaliditetit të cilët dëshmojnë me dokumente zyrtare, dhënies së provimit të do të i nënshtrohen pa kompensim.
5. Vendimin përkitazi me lirimin nga kompensimi në bazë të paragrafit 4 të këtij Udhëzimi e nxjerr Ministri .

Afatet e provimit **Neni 7**

Provimi sipas rregullit mbahet katër herë në vit, datën dhe vendin e dhënies së provimit e cakton Ministria në marrëveshje me kryetarin e Komisionit.

Detyrat e provimit me shkrim **Neni 8**

1. Provimi jepet me shkrim dhe me gojë.
2. Provimi me shkrim jepet nga e drejta penale dhe e drejta civile brenda dy ditëve të njëpasnjëshme.
3. Detyrat nga pjesa e provimit me shkrim i përpilon anëtari i Komisionit për lëndën nga e cila jepet pjesa me shkrim e provimit përkatës.
4. Gjatë provimit me shkrim mund të jepet një detyrë për të gjithë kandidatët, të cilët në të njëjtën kohë japin pjesën me shkrim të provimit, por mund të caktohen edhe detyra të veçanta për secilin ose për me shumë kandidatë të një grupi. Nga kandidatët, sipas rregullit kërkohet që, në bazë të dhënave të prezantuara, të hartohet padia, përgjigjja në padi, aktakuza, kundërshtimi në aktakuzë, vendimi (aktgjykimi ose aktvendimi) apo mjeti juridik kundër vendimeve, etj.

Mënyra e dhënies së provimit me shkrim **Neni 9**

1. Në fillim të pjesës me shkrim të provimit anëtari i Komisionit që pyet lëndën e cila jepet me shkrim, dhe Sekretari i Komisionit konstatojnë identitetin e kandidatëve, pastaj kandidatëve u dorëzohet detyra dhe njoftohen me dispozitat e ligjore në fuqi që duhet t'i respektojnë gjatë kohës së hartimit të detyrës.
2. Provimi me shkrim punohet në mënyrë anonime (me kod). Kodin e cakton Ministria, i cili zbulohet para shpalljes së rezultateve të provimit me shkrim.
3. Gjatë kohës së zgjatjes së provimit me shkrim kandidatit nuk i lejohet të kontaktojë me persona tjerë, (ta përdorë telefonin mobil) as të braktisë lokalit në të cilin mbahet provimi, me përjashtim të rasteve të arsyeshme.
4. Me rastin e hartimit të detyrës me shkrim, kandidati mund të shërbehet vetëm me tekstet e dispozitave ligjore pa komentues .

Koha-zgjatja e provimit me shkrim **Neni 10**

1. Koha për hartimin e detyrës me shkrim zgjatë 5 orë, prej kohës së kumtimit të detyrës. Kandidati detyrohet ta dorëzojë detyrën dhe punimin me shkrim brenda kohës së parashikuar për hartimin e detyrës. Nëse brenda kësaj kohe nuk e dorëzon detyrën dhe punimin ose gjatë kohëzgjatjes së provimit heq dorë nga hartimi i detyrës, konsiderohet se **nuk e ka dhënë provimin.**
2. Koha e dorëzimit të punimit me shkrim do të shënohet në kopertinë të vetë punimit.
3. Kandidati i cili e dorëzon punimin me shkrim detyrohet që ta lëshojë lokalit në të cilin mbahet provimi.

Vlerësimi i provimit me shkrim **Neni 11**

1. Pas kontrollimit të punimeve me shkrim nga ana e anëtarëve të Komisionit, të cilët pyesin lëndën nga e cila jepet pjesa me shkrim e provimit, Ministria e cakton vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e punimeve me shkrim.
2. Vendimin për vlerësimin e suksesit të arritur në punimin me shkrim e miraton Komisioni, me shumicë votash, pas marrjes së mendimit nga anëtarët e Komisionit të cilët i kanë kontrolluar punimet me shkrim.
Punimi me shkrim vlerësohet me **“kalon”** ose **“nuk kalon”**.

Shpallja e rezultateve të provimit me shkrim **Neni 12**

1. Pas përfundimit të pjesës së provimit me shkrim, Ministria në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit e cakton vendin dhe kohën e mbajtjes së provimit me gojë.
2. Para se të fillojë provimi me gojë, kryetari i Komisionit në përbërje të plotë të Komisionit, kandidatëve ua komunikon suksesin e pjesës së provimit me shkrim.
3. Kandidatëve të cilët nuk kanë kaluar pjesën me shkrim të provimit nga **lëmi penal** dhe **lëmi civil**, anëtari i Komisionit pyetës nga lënda e cila jepet pjesa me shkrim e provimit në prani të të gjithë anëtarëve të Komisionit, secilit kandidat veç e veç publikisht do t’ia paraqesin vërejtjet dhe lëshimet e bëra gjatë shtjellimit të detyrës me shkrim.

Kushti për nënshtrim të provimit me gojë **Neni 13**

Kandidati i cili **nuk kalon** pjesën e provimit me shkrim nga **lëmi penal** dhe **lëmi civil** nuk lejohet t’i nënshtrohet dhënies së pjesës me gojë të provimit dhe do të konsiderohet se **nuk e ka kaluar provim**.

Provimi me gojë **Neni 14**

1. Kandidati i cili kalon pjesën me shkrim të provimit nga **lëmi penal** dhe **lëmi civil** ose njëri prej tyre i lejohet t’i nënshtrohet i pjesës me gojë të provimit.
2. Kandidati i cili i nënshtrohet dhënies së pjesës me gojë të provimit, e i cili nuk e ka dhënë pjesën me shkrim të provimit nga njëri prej lëmenjve (penale ose civile) nuk mund t’i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë në lëmin që nuk e ka kaluar pjesën me shkrim të provimit.

Rrjedha e provimit me gojë Neni 15

1. Nëse kandidati në pjesën e provimit me gojë heqë dorë nga provimi ose nuk paraqitet në provim në afatin e caktuar për t'iu nënshtruar provimit, do të konsiderohet se **nuk e ka dhënë provimin**.
2. Pas prezantimit të rezultatit të punimeve me shkrim, kandidatët pyeten me gojë nga lëndët e caktuara sipas radhës që e cakton kryetari i Komisionit. Provimin me gojë kandidatët e japin publikisht para Komisionit provues në përbërje të plotë ose të ndarë në dy grupe.
3. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit me rastin e pyetjes, kandidatit mund t'i bëjnë pyetje edhe nga lëndët që nuk pyesin.
4. Anëtari i Komisionit i cili pyet lëndën nga e cila jepet pjesa me shkrim e provimit, para se ta fillojë provimin me gojë mund të kërkojë nga kandidati që shkurtimisht t'i shpjegojë zgjidhjet e veta, t'i arsyetojë ose ta sqarojë shtjellimin e detyrës.
5. Me qëllim të sigurimit të rendit, Komisioni mund të kufizojë numrin e personave të cilët dëshirojnë të jenë prezent gjatë dhënies së provimit.

Suksesi përfundimtar i provimit Neni 16

1. Pas përfundimit të provimit me gojë, Komisioni në përbërje të plotë me shumicë votash nxjerr vendimin për suksesin e kandidatëve. Suksesin e kandidatit Komisioni e vlerëson sipas rezultatit që ka treguar kandidati në pjesën me shkrim dhe me gojë të provimit dhe vlerësohet me **“ka kaluar “,ose ”nuk ka kaluar “**.
2. Kandidati i cili tregon nivel të lartë të diturisë në provim me shkrim dhe me gojë nga të gjitha lëndët vlerësohet me **“ka dhënë provimin me sukses të dalluar“**.
3. Rezultatit e suksesit në provim e kumton publikisht kryetari i Komisionit.
4. Pas përfundimit të provimit me gojë, Komisioni ia dërgon raportin Ministrisë.

Mbetja e kandidatit në riprovim Neni 17

1. Komisioni pyetës nëse vlerëson se kandidati nuk ka treguar sukses të kënaqshëm në një **përkatësisht në dy lëndë, do të vendosë që sërish të pyetet (riprovohet) nga të njëjtat lëndë**.
2. Afati për paraqitjen e riprovimit nuk mund të jetë më i shkurtër se 2 e as më i gjatë së 6 muaj nga data kur kandidati ka mbetur në riprovim.
3. Nëse kandidati nuk paraqitet në kohën e caktuar për riprovim ose nuk tregon sukses të kënaqshëm në riprovim, konsiderohet se **nuk e ka dhënë provimin**.
4. Kandidatët që mbesin në riprovim nga e drejta penale, përkatësisht nga e drejta civile, e të cilët më parë e kanë kaluar pjesën me shkrim të provimit, me rastin e nënshtrimit të riprovimit, nuk do të i nënshtrohen sërish pjesës me shkrim të provimit.
5. Kandidatët të cilët i nënshtrohen provimit sipas nenit 3 paragrafi 3.3 të Ligjit për provim të jurisprudencës (programi i shkurtuar), në riprovim mund të mbeten vetëm në një lëndë.

Shtyrja i provimit të filluar të jurisprudencës **Neni 18**

1. Provimi i filluar mund të shtyhet nëse kandidati sëmurët, përjeton ndonjë aksident i ndodhë ndonjë rast vdekje në familje ose për ndonjë arsye të ngjashme nuk mund ta vazhdojë provimin.
2. Për shtyrjen e provimit të filluar, vendos kryetari i Komisionit në bashkërendim me Komisionin duke u bazuar në dëshmitë që do t'i prezantojë kandidati.
3. Afati brenda të cilit kandidati duhet t'i nënshtrohet provimit të prolonguar nuk mund të jetë më i gjatë se 3 muaj nga data e shtyrjes të provimit.
Nëse kandidati nuk paraqitet në kohën e caktuar për ta vazhduar provimin e shtyrë, konsiderohet se **nuk e ka dhënë provimin**.

Nënshtrimi i sërishëm i kandidatit në provim **Neni 19**

1. Kandidati i cili nuk e ka dhënë provimin (nuk ka kaluar në provim me shkrim nga e drejta penale dhe civile ose nuk ka treguar sukses të kënaqshëm nga tri e më shumë lëndë) mund ta përsërisë kërkesën për dhënien e provimit brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 6 muaj.
2. Kandidati i cili nuk e kalon provimin për të dytën herë, mund ta përsërisë dhënien e provimit brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 12 muaj.

Mbrojtja e të drejtave të kandidatëve **Neni 20**

1. Kandidati i cili konsideron se sukcesi i tij i përgjithshëm ose sukcesi nga njëra lëndë nuk i është vlerësuar në mënyrë të drejtë, mund t'i parashtojë ankesë Komisionit, brenda tri ditëve të punës, nga dita e komunikimit të rezultateve.
2. Komisioni është i obliguar që brenda afatit të pesë ditëve të punës, ta shqyrtojë ankesën e tij dhe lidhur me të ta njoftojë kandidatin.
3. Nëse ankesa e kandidatit aprovohet, Komisioni duhet ta përsërisë provimin.

Procesverbali **Neni 21**

1. Gjatë provimit mbahet procesverbali i veçantë dhe procesverbali shtojcë për provim me shkrim për çdo kandidat.
2. Në procesverbal shënohen:
 - nr. i procesverbalit (nr. i lëndës) dhe data,
 - emri dhe mbiemri i kandidatit,
 - organi, organizata ku punon kandidati,
 - numri dhe data e aktvendimit për lejimin e dhënies së provimit,
 - për të satën here kandidati i nënshtrohet provimit,
 - data dhe ora e mbajtjes së pjesës me shkrim dhe me gojë të provimit,
 - detyrat për pjesën me shkrim që i janë shtruar kandidatit,
 - konstatimi i Komisionit se a e ka dhënë apo nuk e ka dhënë provimin me shkrim kandidati dhe vërejtjet përkitazi me punimin e shtjelluar,

- pyetjet që i janë shtruar kandidatit në pjesën e provimit me shkrim dhe gojë,
 - vendimi i Komisionit lidhur me rezultatin e tërësishëm të provimit me shkrim dhe me gojë,
 - vërejtjet që janë me rëndësi për rezultatin e provimit me gojë dhe me shkrim,
 - nënshkrimet e kryetarit, anëtarëve dhe të sekretarit të Komisionit,
3. Procesverbalit i bashkëngjiten detyrat e shtjelluara me shkrim të kandidatit.

Evidenca (baza e të dhënave)

Neni 22

1. Ministria mbanë evidencën me shkrim dhe elektronike (bazën e të dhënave) për kandidatet që kanë paraqitur provimin dhe për kandidatët që kanë dhënë provimin. Kjo evidencë mbahet në librin që mund të shfrytëzohet për një apo më shumë vite kalendarike.
2. Evidenca mbahet posaçërisht për secilin vit kalendarik dhe mbyllet në ditën e fundit të punës së vitit përkatës. Në fund të viti kalendarik, evidencën e vërteton Ministri i Drejtësisë.
3. Evidenca përmban të dhëna për kandidatit si në vijim:
 - numrin e lëndës dhe datën e regjistrimit,
 - emrin dhe mbiemrin dhe vendin prej nga është kandidati,
 - datëlindjen dhe vendlindjen e kandidatit,
 - emërtimin e universitetit dhe datën e diplomimit,
 - datën e dhënies së provimit dhe suksesin e arritur në provim dhe vërejtjet.

Certifikata për provimin e dhënë të jurisprudencës

Neni 23

1. Për provimin e dhënë, Ministria brenda afatit prej 6 muajsh nga dita e dhënies së provimit lëshon certifikatën.
2. Certifikatën për provimin e dhënë të jurisprudencës e nënshkruan Ministri.
3. Me kërkesë të kandidatit pas përfundimit të provimit mund të lëshohet vërtetimi i përkohshëm për dhënien e provimit të cilin e nënshkruan sekretari i Komisionit.

Certifikata përmban:

- Logon e organit i cili e lëshon certifikatën,
- numrin dhe datën e lëshimit të certifikatës,
- emrin ,mbiemrin dhe vendbanimin e kandidatit,
- datëlindjen, vendin e lindjes dhe komuna,
- emërtim i universitetit dhe datën e diplomimit,
- datën e dhënies së provimit dhe suksesin,
- emrin e Komisionit para të cilit kandidati e ka dhënë provimin,
- bazën juridike për lëshimin e certifikatës,
- nënshkrimin e Ministrit dhe
- vulën zyrtare.

Lëshimi e certifikatës së humbur-dublikati

Neni 24

- 1) Personit të cilit i humb certifikata për dhënien e provimit , mundë të kërkoj nga Ministria që t'i lëshohet dublikati i certifikatës së humbur.
- 2) Personi i cili kërkon lëshimin e dublikatës së certifikatës, kërkesës për dublikatë duhet t'ia bashkëngjis:
 - vërtetimin që ka shpallur të pa vlefshme certifikatën e humbur dhe
 - fletëpagesën e bërë në bankë në shumë prej 10€ në dobi të llogarisë së Thesarit Kryesor të Kosovës .

Programi i provimit të jurisprudencës

Neni 25

Programi për dhënien e provimit është si vijon:

a) PARIMET DHE STRUKTURAT KUSHTETUESE DHE ORGANIZIMI I GJYQËSORIT

I. Kushtetuta si akt me i lartë juridik dhe politik

1. Kuptimi i Kushtetutës;
2. Llojet e kushtetutave;
3. Roli i Kushtetutës në sistemin juridik;
4. Mënyrat e miratimit dhe ndryshimit të kushtetutave;
5. Kushtetutat me të njohura në botë.

II. Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në sistemet kushtetuese

1. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria si procese juridike dhe politike;
2. Parimi i kushtetutshmërisë;
3. Parimi i ligjshmërisë;
4. Sundimi i së drejtës dhe shteti ligjor;
5. Parimet e shtetit ligjor;
6. Parimi i ndarjes dhe kontrollit reciprok të pushteteve;
7. Mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

III. Shpallja dhe zyrtarizmi i pavarësisë së Kosovës

1. Deklarata e Pavarësisë e datës 17 shkurt 2008;
2. Pakoja e Ahtisarit dhe ligjet që burojnë nga ajo;
3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008.

IV. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

1. Koncepti dhe struktura e Kushtetutës;
2. Preambula;
3. Dispozitat themelore;
4. Liritë dhe te drejtat e njeriut;
5. Marrëdhëniet ekonomike;
6. Organizimi territorial i Republikës;
7. Reforma e pushtetit lokal.

V. Institucionet e Republikës së Kosovës

1. Kuvendi i Republikës

- 1.1 Organizimi dhe struktura e Kuvendit
- 1.2 Kompetencat e Kuvendit
- 1.3 Procesi legjislativ në Kuvend
- 1.4 Mënyrat e miratimit të ligjeve në Kuvend
- 1.5 Shumica e dyfishtë për miratimin e ligjeve
- 1.6 Raportet e Kuvendit me Qeverinë
- 1.7 Kontrolli parlamentar i Qeverisë
- 1.8 Raporti i Kuvendit me Presidentin

2. Presidenti i Republikës

- 2.1 Mënyra e zgjedhjes së Presidentit;
- 2.2 Kompetencat e Presidentit;
- 2.3 Roli i Presidentit në politikën e jashtme;
- 2.4 Raporti i Presidentit me Kuvendin dhe Qeverinë.

3. Qeveria e Republikës

- 3.1 Mënyra e zgjedhjes së Qeverisë;
- 3.2 Funkcionet e Qeverisë;
- 3.3 Roli i Kryeministrit në udhëheqjen e Qeverisë;
- 3.4 Raporti i Qeverisë me Kuvendin e Kosovës.

4. Sistemi gjyqësor

- 4.1 Parimet kushtetuese të organizimit dhe funksionimit të gjyqësorit;
- 4.2 Llojet, organizimi dhe struktura e gjykatave;
- 4.3 Funkcionet e gjykatave;
- 4.4 Zgjedhja, emërimi dhe disiplinimi i gjyqtarëve.

5. Prokuroria Publike

6. Ombduspersoni/Avokati i Popullit/

7. Gjykata Kushtetuese

- 7.1 Organizimi dhe struktura e Gjykatës Kushtetuese;
- 7.2 Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese;
- 7.3 Procedurat para Gjykatës Kushtetuese;
- 7.4 Roli i Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese të qytetarëve.

8. Agjencitë e Pavarura në Republikën e Kosovës

9. Rishikimi i Kushtetutës

10. Dispozitat përfundimtare

11. Dispozitat tranzicionale

VI. HARTIMI I KUSHTETUTËS DHE I LIGJEVE-KLINIKAT PËR KUSHTETUTË DHE LIGJE

1. Kuptimi i hartimit të kushtetutës dhe të ligjeve;
2. Parimet e hartimit të Kushtetutës dhe të ligjeve;

3. Teknika juridike dhe terminologjia e hartimit;
4. Fazat e hartimit;
5. Debatet publike me qytetarët;
6. Procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të Kushtetutës dhe të ligjeve;
7. Ndryshimi i Kushtetutës dhe i ligjeve;
8. Interpretimi i Kushtetutës dhe i ligjeve;
9. Zbatimi i Kushtetutës dhe i ligjeve;
10. Mbrojtja e Kushtetutës dhe e ligjeve.

BURIMET JURIDIKE KUSHTETUESE

Deklarata e Pavarësisë, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 17 shkurt 2008;
 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008;
 Ligjet sistemore të Kuvendit të Kosovës;
 Pakoja e Presidentit Ahtisari;
 Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
 Rregullorja e punës e Kuvendit të Kosovës;
 Rregullorja e punës e Qeverisë së Kosovës (2007/1);
 Doracaku për përgatitjen e provimit të Jurisprudencës;
 Rregullorja 2001/9 – UNMIK;
 Rregullorja 2001/19 – UNMIK;
 Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (është në procedurë të miratimit);
 Statuti i komunës
 Ligji për gjykatat (është në procedurë të miratimit);
 Ligji për prokurime (është në procedurë të miratimit);
 Ligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës (është në procedurë të miratimit);
 Ligji për qeverisjen lokale (është në procedurë të miratimit).

b) E DREJTA PENALE

E DREJTA PENALE MATERIALE

A. PJESA E PËRGJITHSHME

I. VEPRA PENALE

- kuptimi,
- mënyra e kryerjes,
- koha e kryerjes,
- vendi i kryerjes.

II. PËRJASHTIMI I KUNDËRLIGJSHMËRISË

- vepra e rëndësisë së vogël,
- mbrojtja e nevojshme,
- nevoja ekstreme.

III. PËRJASHTIMI I PËRGJEGJËSISË PENALE

- urdhrat nga lartë,
- paaftësia mendore,
- mungesa e lidhjes shkakore,
- lajthimi faktik,
- lajthimi juridik,
- mosha.

IV. PËRGJEGJËSIA PENALE

- dashja,
- pakujdesia,
- pakujdesia e vetëdijshme,
- pakujdesia e pavetëdijshme,
- tentativa dhe tentativa e papërshtatshme.

V. BASHKËPUNIMI

- bashkëkryerja,
- shtytja,
- ndihma,
- bashkimi kriminal
- kufijtë e përgjegjësive penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim.

VI. DËNIMET

- qëllimi i dënimit,
- dënimet kryesore,
- dënimet alternative,
- dënimet plotësuese.

VII. KONFISKIMI I DOBISË PASURORE TË FITUAR ME ANË TË KRYERJES SË VEPRËS PENALE

- bazat e konfiskimit,
- mënyra e konfiskimit,

VIII. PARASHKRIMI

- parashkrimi i ndjekjes penale,
- parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve.

B. PJESA E POSAÇME

XIII. VEPRAT PENALE KUNDËR KOSOVËS DHE BANORËVE TË SAJ

- vështrim i përgjithshëm,
- kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose kufirit, neni 114,
- nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik, neni 115.

XIV. VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

- vështrim i përgjithshëm,
- kontrabandimi me migrantë, neni 138,

- trafikimi me njerëz, neni 139.

XV. VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

- vështrim i përgjithshëm,
- vrasja neni 146,
- ndërprerja e palejuar e shtatzënisë, neni 152,
- lëndimi i lehtë trupor, neni 153.

XVI. VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

- vështrim i përgjithshëm,
- shtrëngimi, neni 160,
- cenimi i paprekshmërisë së banesës, neni 166,
- mashtrimi në votime, neni 180.

XVII. VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE NË MARRËDHENIET E PUNËS

- vështrim i përgjithshëm,
- cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës, neni 182,
- rrezikimi i sigurisë në punë, neni 186.

XVIII. VEPRAT PENALE KUNDËR NDERIT DHE AUTORITETIT

- vështrim i përgjithshëm,
- fyerja, neni 187,
- zbulimi i rrethanave personale dhe familjare, neni 189.

XIX. VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL

- vështrim i përgjithshëm,
- dhunimi, neni 193,
- degradimi i integritetit seksual, neni 196,
- mundësimi i prostitucionit, neni 201.

XX. VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS DHE FAMILJES

- vështrim i përgjithshëm,
- rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës, neni 210,
- keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës, neni 211.

XXI. VEPRAT PENALE KUNDËR SHËNDETIT PUBLIK

- vështrim i përgjithshëm,
- trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor, neni 219,
- mosdhënia e ndihmës mjekësore, neni 220.

XXII. VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

- vështrim i përgjithshëm,
- tregtia e ndaluar, neni 246,
- prodhimi i ndaluar, neni 247.

XXIII. VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË

- vështrim i përgjithshëm,
- vjedhja, neni 252,
- mashtrimi, neni 261,

- pranimi i mallrave të vjedhura, neni 272,
- kontrabandimi me mallra, neni 273.

XXIV. VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE

- vështrim i përgjithshëm,
- vjedhja e pyllit, neni 285.

XXV. VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË

- vështrim i përgjithshëm,
- shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, neni 291.

XXVI. VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK

- vështrim i përgjithshëm,
- rrezikimi i trafikut publik, neni 297,
- mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik, neni 301.

XXVII. VEPRAT PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË

- vështrim i përgjithshëm,
- deklarimet e rrejshme, neni 307,
- pengimi i të provuarit, neni 309.

XXVIII. VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK DHE VEPRIMEVE JURIDIKE

- vështrim i përgjithshëm,
- pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, neni 316,
- sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, neni 317,
- falsifikimi i dokumenteve, neni 331.

XXIX. VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE

- vështrim i përgjithshëm,
- marrja e ryshfetit, neni 343,
- dhënia e ryshfetit, neni 34.

RREGULLORJA E UNMIK-ut 2004/02 MBI PENGIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE VEPRAVE TË NGJASHME PENALE

- obligimet e bankave dhe të institucioneve financiare, neni 3,
- detyrimet e organizatave joqeveritare neni 4,
- detyrimi i partive politike dhe kandidatëve të regjistruar, neni 5,
- obligimet e organizatave afariste, neni 8,
- transakcionet me pasuri të paluajtshme, neni 8,
- veprat penale dhe kompetenca lëndore e gjykatave neni 10.

Vështrimi i përgjithshëm përfshin karakteristikat e përgjithshme të veprave penale nga kapitulli gjegjës, subjektin e veprës penale, objektin e mbrojtur, paditësin e autorizuar për ndjekjen e kryesve të atyre veprave penale.

Burimet juridike:

1. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/25;
2. Rregullorja e UNMIK-t nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës;
3. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/02 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale;
4. Ligji penal për të mitur, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/8.

E DREJTA PENALE PROCEDURALE

PJESA E PARË: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

I. PARIMET THEMELORE

- fillimi i procedurës penale, neni 6,
- parimi i barabarësisë së armëve, neni 7 par. 2.

II. KOMPETENCAT E GJYKATAVE

- kompetenca e gjykatave komunale, neni 21,
- kompetenca territoriale, neni 27,
- mungesa dhe konflikti i kompetencës, nenet 37, 38 dhe 39.

III. PËRJASHTIMI

- arsyet e përjashtimit, neni 40,
- e drejta për të kërkuar përjashtimin dhe procedura, neni 42,
- kompetenca për të vendosur për kërkesën mbi përjashtimin, neni 43.

IV. PROKURORI PUBLIK

- të drejtat themelore dhe detyrat e prokurorit publik, neni 47.

V. PARAQITJA E PROPOZIMIT PËR NDJEKJE PENALE, PADI PRIVATE DHE PËR NDJEKJE SUBSIDIARE

- propozimi për ndjekje, neni 54, 55 dhe 56,
- paditësi privat, nenet 55, 56, 59, 61 dhe 67 par. 1,
- paditësi subsidiar, neni 62, 63, 65 dhe 67 par. 2.

VI. MBROJTËSI

- e drejta në mbrojtje, neni 69 par. 1,
- kush mund të jetë mbrojtës, neni 70,
- mbrojtja e detyruar, neni 73,

VII. IDËMTUARI

- të drejtat e të dëmtuarit, neni 80 dhe 82.

X. AFATET

- llogaritja e afateve, neni 95.

XI. SHPENZIMET E PROCEDURES PENALE

- çka përfshijnë shpenzimet e procedurës penale, 99 par. 2,
- lirimi nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve, neni 102 par. 4.

XII. KËRKESAT PASURORE-JURIDIKE

- e drejta për të paraqitur kërkesën dhe paraqitja e kërkesës, neni 108 dhe 109.

XIII. MARRJA DHE KOMUNIKIMI I VENDIMEVE

- llojet e vendimeve, neni 119,
- mënyra e marrjes së vendimeve neni 120,
- komunikimi i vendimeve, neni 123.

XIV. DORËZIMI I SHKRESAVE

- dorëzimi i shkresave për të cilat nuk është paraparë dorëzimi personal, neni 126,
- dorëzimi i shkresave për të cilat është paraparë dorëzimi personal, neni 127.

XVI. SHIKIMI I SHKRESAVE

- e drejta e të pandehurit dhe e mbrojtësit për të shikuar shkresat 142.

PJESA E DYTË: PROVAT

XIX. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME LIDHUR ME PROVAT

- provat e papranueshme, neni 153 dhe 156,

XX. DËSHMITARËT

- dëshmitaret e privilegjuar, neni 159,
- mënyra e marrjes në pyetje e dëshmitarit në hetime, neni 164, dhe në shqyrtimin gjyqësor, nenet 361-370.

PJESA E TRETË: PROCEDURA PARAPRAKE

XXIII. KALLËZIMI PENAL

- mënyra e paraqitjes së kallëzimit penal, neni 199,
- detyrat e përgjithshme dhe autorizimet e policisë, neni 200 dhe 201,
- detyrat dhe autorizimet e prokurorit publik, neni 208 dhe 209.

XXIV. ARRESTIMI I PËRKOHSHËM DHE NDALIMI NGA POLICIA

- të drejtat e personit të arrestuar, neni 214, 215, dhe 216.

XXV. FILLIMI DHE KOHËZGJATJA E HETIMIT

- fillimi i hetimit, neni 221,
- pezullimi i hetimit, neni 223,
- pushimi i hetimit, neni 224,
- kohëzgjatja e hetimit, neni 225.

XXVIII. VEPRIMET HETIMORE

- marrja në pyetje e të pandehurit, neni 231, 232, 233, 234 dhe 235,
- mundësia hetuese e jashtëzakonshme, neni 238,

- kërkesa e të pandehurit ose e të dëmtuarit për mbledhjen e provave, neni 239,
- kontrolli dhe konfiskimi i përkohshëm, neni 240,
- kontrolli pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake, neni 245,
- sendet që mund të konfiskohen përkohësisht, neni 247,
- këqyrja dhe rikonstruimi, neni 254,
- Identifikimi i personave dhe i sendeve, neni 255.

XXIX. MASAT E FSHEHTA DHE TEKNIKE TË VËZHGIMIT DHE HETIMIT

- lloji i masave, neni 256 par. 1,
- ndaj kujt mund të urdhërohen masat, neni 257,
- masat që i urdhëron prokurori publik, neni 258 par. 1,
- masat që i urdhëron gjyqtari i procedurës paraprake, neni 258 par. 2,
- forma dhe përmbajtja e urdhrat për masë të caktuar, neni 259 par. 1.

XXX. MASAT PËR SIGURINË E PRANISË SË TË PANDEHURIT, PENGIMIN E RIKRYERJES SË VEPRËS PENALE DHE SI GURIMIN E SUKSESSHËM TË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS PENALE

- lloji i masave, neni 268,
- paraburgimi, 281 par. 1,
- kohëzgjatja e paraburgimit neni 284 dhe 285,
- heqja e paraburgimit, neni 286.

XXXI. DËSHMITARI BASHKËPUNUES

- kush mund të jetë dëshmitar bashkëpunues, neni 298.

XXXII. AKTAKUZA DHE KONFIRMIMI I AKTAKUZËS

- ngritja dhe përmbajtja e aktakuzës, neni 304 dhe 305,
- të drejtat e të akuzuarit në seancën e konfirmimit të aktakuzës, neni 309,
- vendimet e gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës, neni 316,
- ankesa kundër aktvendimit për hedhjen e aktakuzës, neni 317.

PJESA E KATËRT: SHQYRTIMI GJYQËSOR

- arsyet e përjashtimit të publikut, neni 329,
- prishja e rendit në shqyrtimin gjyqësor, neni 336,
- shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor, neni 345, 346 dhe 347,
- përmbajtja e procesverbalit mbi shqyrtimin gjyqësor, neni 351,
- fillimi i shqyrtimit gjyqësor, neni 357,
- rendi i prezentimit të provave, neni 360 par. 3,
- ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës, neni 376 dhe 377,
- fjala përfundimtare neni 378,379,380 dhe 381,
- arsyet e hedhjes së aktakuzës, neni 384.

XXXV. AKTGJYKIMI

- aktgjykimi me të cilin refuzohet aktakuza, neni 389,
- aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga aktakuza, 390,
- aktgjykimi me të cilin i akuzuari shpallet fajtor 391,
- përmbajtja e aktgjykimit të përpiluar me shkrim, neni 396.

PJESA E PESTË: PROCEDURA ME MJETE JURIDIKE

XXXVI. ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

- e drejta në ankesë, neni 399,
- detyrimi i paralajmërimit të ankesës, neni 400,
- përmbajtja e ankesës, neni 401,
- arsyet e ushtrimit të ankesës, neni 402,
- kufijtë e shqyrtimit të ankesës, neni 425,
- vendimet e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ankesën, neni 420.

XXXVIII. ANKESA KUNDËR AKTVENDIMIT

- e drejta e paraqitjes së ankesës, neni 431.

XXXIX. MJETET E JASHTËZAKONSHME JURIDIKE

- rishikimi i procedurës penale, nenet 439,
- zbutja e jashtëzakonshme e dënimit, neni 448,
- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, neni 451

PJESA E GJASHTË: PROCEDURA E SHKURTËR, DHËNIA E URDRIT NDËSHKIMOR DHE SHQIPTIMI I VËREJTJES GJYQËSORE

XL. PROCEDURA E SHKURTËR

- aktet për fillimin e procedurës së shkurtër dhe përmbajtja e tyre, neni 462 dhe 465,
- paraburgimi në procedurë të shkurtër, neni 463,
- hudhja e propozimkuzës ose padisë private, neni 468.

XLI. PROCEDURA PËR DHËNIEN E URDRIT NDËSHKIMOR

- dhënia e urdrit ndëshkimor, e drejta në kundërshtim dhe efekti i kundërshtimit, neni 478 dhe 479.

XLII. SHQIPTIMI I VËREJTJES GJYQËSORE

- përmbajtja e aktgjyqimit mbi shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, neni 481.

PJESA E SHTATË: PROCEDURAT E VEÇANTA

XLIII. PROCEDURA NDAJ PERSONAVE TË CILËT KANË KRYER VEPËR PENALE NËN NDIKIMIN E ALKOOLIT OSE TË DROGËS

- aktgjyqimi me të cilin shqiptohen masat, neni 486 par. 1.

XLIV. PROCEDURA E KONFISKIMIT

- konfiskimi i sendeve kur i akuzuari nuk shpallet fajtor ose kur pushohet procedura, neni 489 dhe 498,
- hetimi për vërtetimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, 490.

XLIX. PROCEDURA PËR KOMPENZIMIN E DËMIT, REHABILITIMIN DHE PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË TJERA TË PERSONAVE TË DENUAR OSE TË ARRESTUAR PA ARSYE

- e drejta në kompensimin e dëmit, neni 534, 537 dhe 538,
- e drejta në rehabilitim, neni 539 par. 1, 2 dhe 3,
- e drejta në realizimin e të drejtave të tjera, neni 542 par. 1.

XL. PROCEDURA PËR DHËNIEN E LETËRRESHTIMIT DHE SHPALLJEVE PUBLIKE

- kushtet për urdhërimin e lëshimit të urdhërreshtimit, neni 544 par. 1 dhe 3.

Burimet juridike

*Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26
Rregullorja e UNMIK-ut mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale,
nr. 2004/2*

RREGULLORJA NR. 2004/08 - LIGJI PENAL PËR TË MITUR

PJESA E PARË

I. PARIMET UDHËZUESE

- qëllimi i sistemit të drejtësisë për të mitur, neni 1 par. 1.
- të drejtat e të miturit të privuar nga liria, neni 1 par. 5 dhe 6.

III. FUSHA E ZBATIMIT

- zbatimi i dispozitave të LPM-së, neni 3.

PJESA E DYTË: MASAT DHE DËNIMET E ZBATUESHME

IV. MASAT DHE DËNIMET E ZBATUESHME NDAJ TË MITURVE

- masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturit, neni 6,
- masat që mund t'i shqiptohen personit madhor të ri për veprë penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, neni 8,
- masat dhe dënimet që mund t'i shqiptohen personit madhor për vepra penale të kryera si i mitur, i cili ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, neni 9,
- masat dhe dënimet që mund t'i shqiptohen personit madhor të ri për veprë penale të kryer si person madhor i ri, neni 10.

V. MASAT E DIVERSITETIT

- qëllimi i masave të diversitetit, neni 13,
- kushtet për shqiptimin e masave të diversitetit, neni 14.

VI. MASAT EDUKUESE

- qëllimi i masave, llojet dhe kohëzgjatja, neni 16 dhe 17.

VII. GJOBA DHE URDHRI PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

- gjoba, neni 27,
- urdhri për punë në dobi të përgjithshme, neni 28.

VIII. BURGIMI PËR TË MITUR

- qëllimi i burgimit për të mitur, neni 29,
- kohëzgjatja e burgimit për të mitur, neni 31,
- parashkrimi i ekzekutimit të burgimit për të mitur, neni 33.

PJESA E TRETË: PROCEDURA

X. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

- e drejta e të miturit në mbrojtje, neni 40,
- ndarja dhe bashkimi i procedurës ndaj të miturit dhe personave madhorë, neni 44.

XI. PËRBERJA E TRUPIT GJYKUES

- përbërja e trupit gjykues, neni 49,
- kompetenca territoriale e gjykatës, neni 52.

XII. PROCEDURA PËRGADITORE

- fillimi i procedurës përgatitore, neni 55,
- detyrat e gjyqtarit për të mitur gjatë procedurës përgatitore, neni 57,
- pushimi i procedurës përgatitore, neni 5.

XIII. ARRESTI I PËRKOHSHËM, NDALIMI NË POLICI DHE PARABURGIMI

- kohëzgjatja e arrestit të përkohshëm dhe ndalimit në polici, neni 63 par. 2,
- paraburgimi, neni 64.

XIV. SHQYRTIMI GJYQËSOR

- parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, neni 68,
- jopubliciteti i shqyrtimit gjyqësor, neni 68,
- vendimet e trupit gjykues për të mitur, neni 71.

XV. MJETET JURIDIKE

- e drejta në ankesë, afati i paraqitjes së ankesës dhe efekti i ankesës, neni 75,
- vendimet e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ankesën, neni 76.

PJESA E PESTË: PROCEDURAT GJYQËSORE QË PËRFSHIJNË VEPRAT PENALE TË KRYERA NDAJ FËMIJËVE

- gjykimi i personave madhorë për vepra penale të kryera ndaj fëmijëve, neni 141.

Burimet juridike:

1. *Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26;*
2. *Ligji penal për të mitur, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/08;*
3. *Rregullorja e UNMIK-ut mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale nr. 2004/2.*

LIGJI MBI EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE

PJESA E PARË – PJESA E PËRGJITHSHME

I – DISPOZITAT THEMELORE

- Sanksionet që ekzekutohen sipas dispozitave të këtij ligji, neni 1 dhe 2.

II – EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME BURGIM, ME BURGIM AFATGJATË DHE I DËNIMIT ME GJOBË

- Gjykata kompetente për ekzekutim e dënimeve të përmendura, neni 13 dhe 14.
- Arsytet dhe kohëzgjatja e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit, neni 19,
- Procedura për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, neni 20-23,
- Efekti i kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, neni 24,
- Shtyrja e ekzekutimit të dënimit lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike, neni 28 dhe 29.

III – EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME GJOBË

- Kompetenca dhe procedura për ekzekutimin e dënimit me gjobë, neni 145.

Burimet juridike:

Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale – Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut 2004/46.

c) E DREJTA CIVILE

PJESA E PËRGJITHSHME

I. Parimet e së drejtës civile:

1. Barazia e palëve dhe e vullneteve të tyre,
2. Iniciativa e lirë e palëve (liria e vullnetit),
3. Qarkullueshmëria e të drejtave subjektive civile,
4. Sanksioni pasuror.

II. Subjektet e së drejtës civile:

1. Llojet e subjekteve të së drejtës civile,
2. Personat fizikë – fitimi dhe shuarja e subjektivitetit,
3. Zotësia juridike e personave fizikë,
4. Zotësia për të vepruar e personave fizikë,
5. Zotësia deliktore e personave fizikë,
6. Personat juridikë – fitimi dhe shuarja e subjektivitetit,
7. Dallimet përkitazi me zotësinë juridike dhe për të vepruar mes personave fizikë dhe juridikë.

III. Objektet e marrëdhënieve juridike - civile:

1. Llojet e objekteve të marrëdhënieve juridike-civile: sendet, veprimet e njeriut, pasuria dhe vlerat personale.

IV. E drejta subjektive civile:

1. Nga rrjedhin të drejtat subjektive dhe çka përmbajnë,
2. Ndarja e të drejtave subjektive civile (absolute dhe relative),
3. Llojet e të drejtave subjektive civile absolute varësisht nga objekti,
4. Dallimi mes të drejtave absolute dhe relative varësisht nga raporti ekzistues mes të drejtave dhe detyrimeve,
5. Krijimi, ndryshimi dhe shuarja e të drejtave subjektive civile,

6. Mënyra e fitimit të drejtave subjektive civile (originare dhe derivative),
7. Sukcesioni universal dhe i vetëm,
8. Faktet juridike,
9. Supozimet dhe fiksionet juridike.

V. Punët juridike:

1. Kuptimi dhe kushtet për krijimin e punës së vlefshme juridike,
2. Llojet e punëve juridike: të njëanshme dhe të dyanshme, me barrë dhe bamirëse, formale dhe joformale, komutative dhe aleatore, mes të gjallëve(inter vivos) dhe për rast të vdekjes (mortus causa),
3. Punët juridike të pavlefshme, llojet,
4. Punët juridike nule, shkaqet e nulitetit,
5. Punët juridike të rrëzueshme, shkaqet e anulimit,
6. Kundërshtimi i punëve juridike,
7. Pasojat juridike të punëve juridike të pavlefshme,
8. Mundësia e konvalidimit të punëve juridike të pavlefshme,
9. Modifikimi i punëve juridike (kushti, urdhri dhe afati).

VI. Përfaqësimi:

1. Kontraktues (me autorizim);
2. Ligjor;
3. Gjyqësor;
4. Përfaqësimi i personave juridikë (statutar).

VII. Parashkrimi:

1. Kuptimi, afatet e përgjithshme dhe të veçanta;
2. Rrjedha, ndërprerja dhe ndalja e rrjedhës së afatit;
3. Afatet prekluzive.

VIII. Cenimi dhe mbrojtja e të drejtave subjektive civile:

1. Cenimi i të drejtës subjektive civile;
2. Mbrojtja gjyqësore;
3. Vetëmbrojtja.

E DREJTA SENDORE

I. Parimet themelore me të cilat karakterizohen të drejtat sendore:

1. Parimi i absolutitetit;
2. Parimi i numrit të përkufizuar të të drejtave sendore;
3. Parimi i publicitetit;
4. Parimi i (specifitetit) caktueshmërisë së të drejtave sendore.

II. Sendet:

1. Kushtet që diç të ketë kuptimin e sendit;
2. Ndarja e sendeve, me rëndësi për të drejtën civile;
3. Frutat.

III. Posedimi (Possesio):

1. Kuptimi dhe rëndësia e posedimit;
2. Objekti i posedimit;

3. Ndarjet e posedimit varësisht nga lloji (i ligjshëm dhe jo i ligjshëm; në mirëbesim dhe keqbesim; i drejtë dhe me të meta, posedimi i pavarur (autonom) dhe bashkëposedimi; posedimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë);
4. Pozita juridike e poseduesit në mirëbesim dhe keqbesim;
5. Fitimi dhe humbja e posedimit;
6. Mbrojtja gjyqësore e posedimit;
7. Specifikat e procedurës në kontestet për pengim posedimi;
8. Masat e përkohshme në kontestet për pengim posedimi;
9. Vetëmbrojtja.

IV. Pronësia:

1. Kuptimi dhe përmbajtja e të drejtës së pronësisë;
2. Subjektet e të drejtës së pronësisë;
3. Të drejtat e tjera të pronarit të objektit banesor të ndërtuar në bazë të ligjit në pronën shoqërore;
4. Bashkëpronësia, prona e përbashkët dhe pronësia në etazhe;
5. Fitimi i të drejtës së pronësisë (sipas ligjit, me punë juridike, me trashëgim dhe me vendim të organit shtetëror);
6. Mënyra origjinere (okupimi, thesari, komasacioni, sipas lejes administrative, nga jopronari, parashkrimi fitues, krijimi i sendit të ri, konfiskimi, nacionalizimi shpronësimi, ndërtimi në tokë të huaj);
7. Mënyra derivative (baza juridike dhe mënyra e fitimit);
8. Llojet e padisë për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë (Actio reivindicatio, Actio publiciana dhe Actio negatoria);
9. Humbja e të drejtës së pronësisë.

IV.E drejta e përparësisë së blerjes – kuptimi dhe rastet.

VI. E drejta e servitutit:

1. Servitutet personale (kuptimi, llojet dhe përkufizimi në kohë);
2. Servitutet reale - kuptimi dhe ndarjet e tyre varësisht nga përmbajtja dhe vëllimi;
3. Mënyra e fitimit të drejtës së servituteve (me punë juridike, sipas vendimit të organit shtetëror, në bazë të posedimit);
4. Humbja e të drejtës së servituteve;
5. Llojet e padisë nga praktika gjyqësore përkitazi fitimin, humbjen dhe vërtetimin e ekzistimit të së drejtës së servitutit.

VII. E drejta e pengut:

1. Objekti i pengut;
2. Llojet e pengut (standard, posedimor ose peng i blerjes);
3. Krijimi dhe vendosja e pengut;
4. Marrëveshja e pengut;
5. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me kolateralin;
6. Kur përfundon pengu,
7. Marrja e kolateralit nga pengmarrësi në rast mospërbushjeje nëpërmjet të gjykatës.

VIII. Hipoteka:

1. Objekti i hipotekës;
2. Kërkesat e siguruara me hipotekë;
3. Shuarja e hipotekës;

4. Ekzekutimi i kolateralit të hipotekës nëpërmjet të gjykatës (procedura).

-E DREJTA FAMILJARE

I. Afërsia gjinore:

1. Llojet e gjinisë;
2. Llogaritja e gjinisë.

II. Fejesa:

1. E drejta dhe përgjegjësia për dëmshpërblim për heqje dorë nga fejesa,
2. Fati i dhuratave të këmbyera në rast të prishjes së fejesës.

III. E drejta martesore:

1. Kushtet për lidhjen dhe vlefshmërinë e martesës;
2. Ndalesat dhe pengesat martesore;
3. Vendi dhe procedura e lidhjes së martesës zyrtare;
4. Kushtet për lidhjen e martesës religjioze dhe regjistrimi i saj;
5. Kushtet për lidhjen e martesës së shtetasve të huaj sipas LFK-së, dhe shtetasve kosovarë në botën e jashtme;
6. Mënyrat e shuarjes së martesës;
7. Martesat absolute nule;
8. Martesat relative nule;
9. E drejta në padi për anulimin e martesës;
10. Pasojat e anulimit të martesës;
11. Shkaqet e shkurorëzimit;
12. E drejta në padi për shkurorëzim;
13. Mundësia e vazhdimit të procedurës nga trashëgimtarët;
14. Shkurorëzimi me marrëveshje;
15. Pasojat e anulimit dhe shkurorëzimit të martesës, veçmas për ushqim;
16. Specifikat e procedurës në kontestet martesore;
17. Pasuria e veçantë e bashkëshortëve;
18. Pasuria e përbashkët, mënyra e disponimit dhe qeverisjes, si dhe ndarja e pasurisë së përbashkët.

IV. Bashkësia jashtëmartesore: Efektet juridike të bashkësisë jashtëmartesore

V. Marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve:

1. Prezumimet e atësisë martesore;
2. Kundërshtimi i atësisë martesore;
3. Kundërshtimi i atësisë jashtëmartesore;
4. E drejta prindërore, privimi dhe zgjatja e kujdesit prindëror.

VI. Adoptimi (birësimi):

1. Kushtet ligjore për adoptim përkitazi me adoptuesit dhe të adoptuarit;
2. Autoritetet kompetente për vendosje dhe procedura për adoptim;
3. Të drejtat dhe detyrimet mes adoptuesit dhe të adoptuarit;
4. Shuarja – anulimi i adoptimit dhe pasojat.

VII. Kujdestaria:

1. Llojet e kujdestarisë, varësisht nga subjektet nën kujdes dhe qëllimi i kujdesit, (kujdestaria ndaj personave të mitur, personave të rritur pa aftësi për të vepruar dhe kujdestaria për raste të veçanta).

VIII. Detyrimi ligjor për ushqim:

1. Mes bashkëshortëve;
2. Mes prindërve dhe fëmijëve;
3. Forma e ushqimit, varësisht nga personi që gëzon këtë të drejtë;
4. Caktimi i lartësisë së detyrimit për ushqim ligjor;
5. Kompetenca lëndore dhe vendore e gjykatave për vendosje lidhur me ushqimin.

IX. Marrëdhëniet pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare:

1. Administrimi i pasurisë (veçmas asaj të paluajtshme, regjistrimi në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme);
2. Marrëveshjet kontraktuese mes anëtarëve lidhur me pasurinë e përbashkët.

X. Mbrojtja kundër dhunës në familje:

1. Dhuna në familje sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/12;
2. Masat mbrojtëse;
3. Llojet e urdhrave për mbrojtje nga dhuna në familje;
4. Organet kompetente për lëshimin e urdhrave;
5. Pasojat e shkeljes së urdhrave.

PROCEDURA E EKZEKUTIMIT

I. Subjektet në procedurën e ekzekutimit.

II. Dokumentet ekzekutive.

III. Objekti i ekzekutimit.

IV. Kushtet procedurale dhe materiale për marrjen e vendimit të ekzekutimit.

V. Kundërshtimi i debitorit në vendimin për ekzekutim:

1. Arsyet ligjore për kundërshtim;
2. Afatet për parashtrimin e kundërshtimit;
3. Udhëzimi në kontest.

VI. Kundërshtimi nga personi i tretë:

1. Arsyet ligjore;
2. Procedura;
3. Udhëzimi në kontest.

VII. Mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme në procedurën e ekzekutimit.

VIII. Kushtet ligjore dhe afatet për kundërekzekutim.

IX. Arsyet ligjore për shtyrjen dhe pezullimin e ekzekutimit.

X. Mjetet e ekzekutimit:

1. Me qëllim të pagesës së kërkesës në të holla;
2. Me qëllim të pagesës së kërkesave të tjera që nuk janë në të holla.

XI. Përjashtimi i sendeve nga ekzekutimi:

1. Ato të luajtshme;
2. Të paluajtshme;
3. Kërkesave në të holla.

XII. Procedura e sigurimit:

1. E drejta e pengut në paluajtshmëri;
2. Masat paraprake;
3. Masat e përkohshme.

PROCEDURA JOKONTESTIMORE**I. Specifikat e procedurës jokontestimore, dallimet krahasuar me procedurën kontestimore.****II. Pjesëmarrësit në procedurën jokontestimore.****III. Parimet e procedurës jokontestimore.****IV. Procedura e paraparë përkitazi me mjetet juridike.****V. Vendosja përkitazi me çështjen paraprake dhe udhëzimi në kontest.****VI. Procedurat e veçanta:****VII. Rregullimi i gjendjeve personale:**

1. Heqja e zotësisë për të vepruar;
2. Mbajtja në organizatën shëndetësore që ushtron veprimtari neuropsikiatrike;
3. Shpallja e personit të humbur për të vdekur dhe argumentimi i vdekjes.

VIII. Rregullimi i marrëdhënieve familjare:

1. Zgjatja e së drejtës prindërore;
2. Heqja dhe kthimi i së drejtës prindërore;
3. Dhënia e lejes për lidhjen e martesës.

IX. Procedurat për rregullimin e marrëdhënieve pasurore:

1. Shqyrtimi i pasurisë trashëgimore;
2. Caktimi i shpërblimit për paluajtshmërinë e shpronësuar;
3. Rregullimi i qeverisjes dhe i shfrytëzimit të sendit të përbashkët;
4. Ndarja e sendit ose pasurisë së përbashkët;
5. Rregullimi i mexhave;
6. Përpilimi dhe vërtetimi i përmbajtjes së dokumentit (testamenti gjyqësor).

BURIMET JURIDIKE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/10 për shfuqizimin e legjislacionit diskriminues lidhur me çështjet banesore dhe të drejtat mbi pronën;
Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe nr. 2000/59 për ligjin në fuqi në Kosovë;
Ligji mbi bazat e marrëdhënieve pronësore juridike (“Gaz. Zyr. e RSFJ-së”, nr. 6/80);
Ligji për qarkullimin e pasurisë së paluajtshme, (“Gaz. Zyr. e KSAK”, nr. 45/81; 29/86; 28/88);
Ligji për shpronësim, (“Gaz. Zyr. e KSAK”, nr. 21/78 dhe 46/86);
Ligji për tokën ndërtimore, (“Gaz. Zyr. e KSAK”, nr. 14/80 dhe 42/86);
Ligji për bashkëpronësinë, (“Gaz. Zyr. e KSAK”, nr. 43/80 dhe 22/87);
Ligji për themelimin regjistrin të të drejtave të pronës së paluajtshme, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2003/13;
Ligji për pengun Rreg. e UNMIK-ut nr. 2001/5;
Ligji për themelimin e zyrës së regjistrimit të pengut Rreg. e UNMIK-ut nr. 2001/32;
Ligji për hipotekat, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2002/21;
Ligji për krijimin e regjistrave për të drejtën e pronës, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2002/22;
Ligji për pyjet e Kosovës, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2003/6;
Ligji për rrugët, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2003/24;
Ligji për kadastër, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2004/4;
Ligji për ujërat, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2004/41;
Ligji për tokat bujqësore, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2006/37;
Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2006/46;
Ligji për gjykatat e rregullta (“Gaz. Zyr. e KSAK”, nr. 21/78);
Ligji për procedurën kontestimore (“Gaz. Zyr. e RFSJ-së”, nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90, 27/90, 35/91, “Gaz. Zyr. E RSFJ-së”, nr. 27/92, 31/93, 24/94);
Ligji për procedurën e ekzekutimit (“Gaz. Zyr. RSFJ”, nr. 20/78);
